

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

**Pozicioni: Lektor/Asistent-Lektor /
Fakulteti I Inxhinierisë dhe Arkitekturës
Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit**

Tipologjia: Me kohë të plotë

Afati i aplikimit: 20.07.2026

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) është një universitet me një përvojë 15- vjeçare i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike & IT. I njohur për qasjen inovative në arsim dhe kërkimin shkencor, UMT është institucioni i parë në Shqipëri që ka integruar Inteligjencën Artificiale në të gjitha ciklet e studimit, Bachelor, Master dhe Doktoraturë, në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare, duke ofruar një formim të orientuar drejt profesioneve të së ardhmes.

UMT është i angazhuar fuqimisht në ndërkombëtarizim, duke ndërtuar partneritete me universitete dhe institucione kërkimore në Europë dhe SHBA, si dhe në krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm inovacioni dhe sipërmarrjeje, që mbështet zhvillimin e ideve dhe projekteve nga studentët dhe stafi akademik.

Në kuadër të zgjerimit të ekipit të tij, UMT fton të aplikojnë kandidatë të kualifikuar, me eksperiencë dhe bashkëpunues për **pozicionin Lektor dhe Asistent-Lektor në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës**.

Kriteret kryesore për të aplikuar për pozicionin janë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë bachelor dhe master shkencor në Inxhinieri Ndërtimi preferohen ata që kanë fituar Gradën shkencore “Doktor i shkencave” në këtë fushë ose të jetë në proces doktore.
- Të zotërojë njohuri të avancuara në shkencat e strukturave, dinamikën dhe sizmikën.
- Të ketë njohuri të mira në përdorimin e softuerëve të analizës dhe llogaritjes së konstruksioneve.
- Të ketë njohuri të mira në projektimin e rrugëve dhe infrastrukturës rrugore.
- Të ketë interes në kërkim shkencor dhe zhvillim profesional në fushën akademike.
- Të ketë aftësi të forta organizative dhe bashkëpunuese.
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të ekipit.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikuese.



- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë eksperiencë të paktën tre vite në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Aplikimi

Kandidatët duhet të dërgojnë në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- Letër motivimi.
- Dëshmi penalitetit
- CV (Curriculum Vitae) përfshirë listën e botimeve shkencore dhe referimeve në konferenca shkencore brenda ose jashtë vendit.
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit Bachelor dhe “Master i Shkencave”.
- Dëshmi e titullit “Doktor i Shkencave” apo tituj të tjerë akademikë, ose vërtetim të ndjekjes së ciklit të tretë të studimeve “Doktorale”.
- Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent (MAS).
- Portofol të punimeve të kryera.
- Dëshmi e mbrojtjes së gjuhës Angleze.

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al